




# DEMOKRACIA



TË DREJTAT  
E BARABARTA

TOKA



# SOVRANITET I POPULLIT

# TË GJITHË TË BARABARTË NË DEMOKRACI

ARTIOL (11), ENSAR (11), GENATA (11), EMIRJONA (11), PRANVERA (11), ARIANA (11), ERON (11)



## Demokracia luan një rol të rëndësishëm në jetën tonë. Mirëpo, edhe ne kemi një rol të rëndësishëm ne demokraci

Çka është demokracia? Demokracia është udhëheqje e popullit me anë të votës.

Kosova është një shtet demokratik dhe ne jemi qytetarë të saj. Si të fillë, ne kemi të drejta por edhe përgjegjësi. Për shembull, ne kemi të drejtë të votojmë në moshën 18 vjeçare, kemi të drejtën e strehimit, të drejtën e të pasurit një familje, të drejtën e shkollimit, të drejtën e lojës dhe argëtimit, të drejtën e të shprehurit



lirshëm etj. Në demokraci duhet të mbizotëroj toleranca, solidariteti, liria dhe barazia, sepse këto janë elementet apo parimet e demokracisë. Është shumë e rëndësishme të jetojmë në bazë të këtyre elementeve që na ofron demokracia.

Populli e përfaqëson atë, pra, mund të themi se ne jemi ata të cilët punojmë për lirinë dhe demokracinë. Demokracia lindi në Athinë, në kryeqytetin e Greqisë

në vitin 507 p.e.s. Fjala demokraci po ashtu rrjedh nga gjuha greke, „demos“ që i bie popull dhe „kratia“ udhëheqje. Ekzistojnë dy lloje të demokracisë, e ato janë: demokracia përfaqësuese dhe ajo e drejtpërdrejtë. Demokracia përfaqësuese është kur populli zgjedh përfaqësuesit e tij, siç ndodh në vendin tonë. Ndërkaq, në demokracinë e drejtpërdrejtë apo direkte populli direkt i mer vendimet e veta. Sof, demokracia është krejt ndryshe nga ajo e mëparshme. Më parë, vetëm burrat kanë mundur të marrin pjesë në votime. Ndërsa sot, të gjithë kanë të drejtë të votojnë pasi të arrijnë moshën 18 vjeçare.

Në demokraci të gjithë jemi të barabartë, pa dallim moshe, gjinie, feje, race, apo kombi. Edhe në shkollën tonë të gjithë i kemi të drejtat e barabarta.

Ne i porosisim të gjithë lexuesit që t'i trajtojmë të gjithë në mënyrë të njëjtë. Të gjithë duhet të kemi mirëkuptim në mes vete, sepse vetëm kështu ne do të jemi një popull i suksesshëm dhe i lumtur.




Gazetarët e artikullit



## ZGJEDHJET E LIRA

ARNISA (11), HAJRIA (11), SEADI (11), NAZMIJA (11), ARLINDI (11), XHABIRI (11), DRENI (11)



### Në artikullin tonë, do të mësoni për zgjedhjet dhe rëndësinë e tyre

Zgjedhjet mund të bëhen në çdo fazë të jetës, por kur mendojmë për zgjedhjet personale, e kemi fjalën tek zgjedhja e veshjeve që neve na pëlqejnë, ngjyrës apo edhe e profesionit të cilin mendojmë të zgjedhim për të ardhmen. Por, pse janë të rëndësishme zgjedhjet? Zgjedhjet janë të rëndësishme, sepse na mundësojnë neve fëmijëve, po ashtu edhe të rriturve të jetojmë me atë që na pëlqen dhe që na bën të ndihemi mirë.

Ne e morëm si shembull zgjedhjen që ne si fëmijë e bëjmë çdo ditë, e cila ishte zgjedhja e rrobave. Ndërsa tek zgjedhja e profesionit, ne kemi të drejtë të zgjedhim profesionin që ne mendojmë që mund ta bëjmë më së miri.

Ne iu treguam pak për zgjedhjet e përditshmërisë, pra

se çdo të thotë të zgjedhësh. Ndërsa, tani do t'iu tregojmë se çka janë zgjedhjet dhe sa lloje të zgjedhjeve kemi ne në vendin tonë, Kosovë.

Zgjedhjet janë forma më demokratike për të ardhur në pushtet, e kjo arrihet përmes votës. Kemi dy lloje të zgjedhjeve, zgjedhjet qendrore dhe zgjedhjet lokale.

Në zgjedhjet qendrore qytetarët votojnë për deputetët ose ndryshe përfaqësuesit e popullit, të cilët kanë mandat 4 vjeçar. Kurse në zgjedhjet lokale qytetarët votojnë për kryetarët e komunave dhe asambleistët të cilët, po ashtu kanë mandat 4 vjeçar.

Pra, të gjithë këta qytetarë që votojnë, natyrisht se janë mbi moshën 18 vjeçare, sepse vetëm kur të arrijmë këtë moshë kemi të drejtë të votojmë. Në një të ardhme të afërt, edhe ne do të gëzojmë të drejtën e votës, po ashtu edhe të drejtën për t'u kandiduar. Kjo është e drejta jonë dhe ne duhet ta shfrytëzojmë atë.



Këtu kemi vizatuar një dorë me një votë



Autorët e artikullit

## KUVENDI (PARLAMENTI)

ALBIN (11), BEHARI (11), BLEURITA (11), ERONA (11), LAURA (11), BLERIM (12), ERISA (11)

### Kuvendi si institucioni më i rëndësishëm shtetëror në të cilin miratohen ligjet

Ligjet janë rregulla të shkruara, të cilat qytetarët duhet t'i zbatojnë. Njëri ndër ligjet është respektimi i të drejtave të fëmijëve. Të drejtat e fëmijëve janë: e drejta e shkollimit, e drejta e të shprehurit lirshëm, e drejta e zgjedhjes së lirë, e drejta e profesionit, etj. Edhe ne në grup sot kemi pasur të drejtë të shprehim mendimet tona lidhur me temën, e cila po shtjellohet në këtë artikull. Me miratimin ose me mos miratimin e këtyre ligjeve merret Kuvendi i Kosovës.

Përveç këtij funksioni, ky institucion ka edhe dy funksione të tjera. Ato janë: funksioni përfaqësues, sepse aty janë 120 deputetë të cilët na përfaqësojnë neve, ku 20 prej tyre janë prej komuniteteve jo shumicë. Si dhe funksioni kontrollues, sepse kontrollon Qeverinë. Gjatë mbledhjeve plenare të Kuvendit marrin pjesë: Kryetari i Kuvendit, nënkryetarët e Kuvendit dhe deputetët. Gjithashtu, në Kuvend janë disa grupe punuese që ndryshe quhen komisione parlamentare. Shpresojmë që ju do të kënaqeni duke lexuar artikullin tonë, si dhe do të merrni disa informata rreth Kuvendit.



Grupi i cili ka shkruar artikullin



Ligji për të drejtat tona



Ne bashkëpunojmë





# NDARJA E PUSHTETIT NË KOSOVËN TONË

YLLI (11), BLERON (11), FATMIRE (12), NJOMZA (11), BLERTA (12), RINESA (11)



## Ne nxënësit e klasës së VI-1 duam t'iu tregojmë disa fakte mbi ndarjen e pushtetit së Kosovës

Ashtu siç e mësuam, në Kosovë ndarja e pushtetit bëhet në degën e Legjislativit, Ekzekutivit dhe Gjyqësorit. Dega e parë është dega Legjislative, me përfaqësues Kuvendin e Kosovës. Në Kuvend marrin pjesë 120 deputetë, prej tyre 100 deputetë janë qytetarë shumicë të Kosovës. Ndërsa, 10 deputetë janë qytetarë serbë, dhe 10 të tjerë janë qytetarë nga komunitetet e tjera jo shumicë. Këto komunitete janë komuniteti boshnjak, romë, ashkali, turk dhe të tjerë.

Kuvendi bën miratimin e ligjeve dhe nxjerrjen e ligjeve të reja. Ligjet janë rregulla, të cilat shkruhen në mënyrë që shteti ynë të funksionoj më mirë. Kuvendi është një institucion legjislativ. Fjala legjislativ do të thotë „ligjvënës“. Një institucion ligjvënës është ai institucion i cili i vë ligjet e një shteti.

Dega e Pushtetit Ekzekutiv përbëhet nga Qeveria e Kosovës. Detyra e këtij institucioni është zbatim i ligjeve në të gjithë territorin e shtetit tonë.

Gjykatatat e përbëjnë degën e tretë të pushtetit, që është Pushteti Gjyqësor. Detyrat e Pushtetit Gjyqësor janë: vendosja e drejtësisë në vend dhe gjykimi i qytetarëve nëse ata e kanë shkelur ligjin apo jo. Gjykatat në Kosovë ndahen në Gjykatën Themelore, të Apelit dhe atë Supreme. Të gjitha vendimet që i merr gjykata duhet të përputhen me Kushtetutën e Kosovës. Dhe siç e kemi mësuar ne, Kushtetuta është akti më i lartë juridik në një vend.

Ne mendojmë se pushteti duhet të ndahet, njëjtë sikurse ne ndajmë punët në mes vete. Në këtë mënyrë, këto institucione e kanë më të lehtë të kryejnë punët. Punët, poashtu kryhen shumë më shpejt, sesa nëse ato do të ishin përgjegjësi e një institucioni të vetëm.



Gazetarët, autorë të artikullit



Artikulli ynë duke u shkruar



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPËSTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Hilmi Rakovica“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI-1  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë